

Në bazë të nenit 184 paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 91/2008, 119/2010 dhe 23/2013) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në seancën e mbajtur më \_\_\_\_2018, miratoi

KODIN  
E SJELLJES ETIKE TË DEPUTETËVE NË  
KUVENDIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Objekti  
Neni 1

Me këtë Kod rregullohen parimet, rregullat dhe standardet themelore etike të sjelljes së deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë (në tekstin në vijim: Kuvendi).

Qëllimi  
Neni 2

(1) Qëllimi i këtij Kodi është ruajtja dhe afirmimi i dinjitetit dhe reputacionit të Kuvendit dhe deputetëve.

(2) Ky Kod ka për qëllim ta rris besimin e qytetarëve dhe publikut në vlerat themelore dhe integritetin e funksionit deputet si personalitet i Kuvendit, si organ përfaqësues i qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe bartës i pushtetit ligjvënës.

II. PARIMET THEMELORE ETIKE

Parimet themelore etike  
Neni 3

Deputeti gjatë ushtrimit të funksionit të tij u përmbahet parimeve themelore etike, standardeve dhe rregullave të sjelljes profesionale, siç janë: objektiviteti, transparencja dhe përgjegjshmëria, respektimi i ndërsjellë, respektimi i reputacionit të Kuvendit, si dhe respektimi i integritetit të personave të tjerë.

Objektiviteti  
Neni 4

Deputeti e ushtron funksionin pa paragjykime dhe diskriminim në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes nacionale dhe sociale, bindjes politike dhe fetare, pozitës pronësore dhe shoqërore, duke i respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit.

Transparenca dhe përgjegjshmëria  
Neni 5

(1) Deputeti gjatë aktiviteteve dhe veprimeve të tij udhëhiqet nga interesi publik, me ç'rast nuk guxon ta shfrytëzojë funksionin e tij për fitimin e dobisë personale ose dobisë së personave të afërt, as të pranojë shërbime, dhurata ose donacione të cilat do të ndikonin mbi aktivitetet e tij dhe vendimmarrjen gjatë punës në Kuvend.

(2) Deputeti, e ushtron funksionin e tij me vetëdije dhe përgjegjësi edhe gjatë ushtrimit të funksionit është i hapur ndaj medias për të gjitha çështjet, përveç çështjeve në kompetencë të Kuvendit të cilat janë të karakterit konfidencial ose informacioneve që kanë të bëjnë me jetën e tij private ose me jetën private të personave të tjerë.

### Respektimi i ndërsjellë dhe respektimi i integritetit personal të të tjerëve Neni 6

(1) Deputeti e ka për detyrë gjatë ushtrimit të funksionit të jetë posaçërisht i vëmendshëm dhe ta respektojë personalitetin dhe reputacionin e çdo individi dhe çdoherë të mbaj llogari të mos e cenojë reputacionin e deputetëve të tjerë dhe reputacionin e Kuvendit.

(2) Deputeti nuk guxon t'i ndërpresë folësit, të hedhë fjalë nga vendi ose në cilëndo qoftë mënyrë tjetër ta prishë rrjedhën e seancës dhe të përdorë fjalë fyese, fraza, shprehje ose gjestikulacione me të cilat mund të fyhen ose përçmohen deputetët e tjerë ose bartësit e funksioneve publike.

(3) Deputeti përmbahet nga veprimet dhe fjalimet me të cilat mund të nxisë urrejtje, intolerancë dhe dhunë në bazë personale, ideologjike, fetare, nacionale, gjinore dhe racore.

(4) Deputeti i respekton autorizimet e personave të tjerë të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve shtetërorë dhe të punësuarve të tjerë në Shërbimin e Kuvendit, nuk do të ushtrojë presion gjatë kryerjes së detyrave të tyre të punës dhe nuk do të stimulojë dhe ndihmojë sjellje në kundërshtim me Kodin.

## III. RREGULLAT E SJELLJES

### Rregulla themelore të sjelljes Neni 7

(1) Deputeti e ka për detyrë t'i respektojë rregullat e sjelljes për mbajtjen e rendit në seancat e Kuvendit, në trupat punues dhe në trupat e tjerë të Kuvendit, dhe veçanërisht:

- të ketë sjellje të vëmendshme dhe ta respektojë personalitetin dhe reputacionin e çdo individi dhe të mbajë llogari të mos e cenojë reputacionin e deputetëve të tjerë dhe reputacionin e Kuvendit;

- të mos përdorë fjalë dhe shprehje me të cilat do të cenojë ose përçmojë persona të tjerë, dinjitetin e njeriut dhe do të nxisë urrejtje, intolerancë dhe dhunë;

- t'i përmbahet temës për të cilën zhvillohet diskutimi;

- të mos e ndërpresë folësin ose në cilëndo qoftë mënyrë tjetër ta prishë rrjedhën e seancës/mbledhjes;

- të mos e përdorë telefonin celular dhe laptopin në mënyrë me të cilën do ta prishë rrjedhën e seancës/mbledhjes; dhe

- t'i respektojë rregullat e veshmbathjes modeste.

(2) Në Kuvend ndalohet rreptësisht përdorimi i forcës dhe sjelljes së dhunshme nga ana e deputetit. Deputeti nuk guxon të marrë pjesë në ngjarje me të cilat rrezikohet siguria e Kuvendit.

(3) Deputeti, në të gjitha paraqitjet e tij publike në të cilat merr pjesë si përfaqësues i Kuvendit, në Kuvend dhe jashtë tij, e ka për detyrë ta respektojë reputacionin dhe dinjitetin e Kuvendit.

#### Konflikti i interesave

##### Neni 8

Deputeti e ka për detyrë t'i respektojë rregullat që kanë të bëjnë me parandalimin e konfliktit të interesit publik dhe privat.

#### Ndalimi i korrupsionit

##### Neni 9

Deputeti gjatë ushtrimit të funksionit e ka për detyrë t'i respektojë rregullat që kanë të bëjnë me ndalimin e korrupsionit si dhe t'i shmangët çdo sjelljeje e cila konform legjislacionit vendas dhe ndërkombëtar do të mund të kualifikohet si veprim korruptiv ose devijim nga rregullat e Kodit.

#### Ndalimi i pranimit të dhuratave

##### Neni 10

Deputeti nuk guxon ta përdorë funksionin e tij për realizimin e dobisë pronësore dhe dobisë tjetër për vetvete ose për të tjerë, nuk guxon të kërkojë dhe/ose të pranojë dhurata dhe shërbime falas si dhe nuk guxon ta përdorë funksionin e tij apo informacionet që i ka pranuar përmes ushtrimit të funksionit të tij për dobi personale ose për dobinë personale të dikujt tjetër.

#### Disiplina buxhetore dhe financiare

##### Neni 11

Deputeti gjatë ushtrimit të funksionit e respekton disiplinën buxhetore dhe financiare me qëllim të menaxhimit të drejtë me mjetet publike dhe nuk do të ndër marrë veprime për shpenzime pa dedikim të mjeteve publike.

#### Sjellja ndaj objekteve/sendeve të cilat përdoren në Kuvend

##### Neni 12

Deputeti me kujdes të veçantë sillet ndaj objekteve të cilat përdoren në Kuvend dhe ndërmerr masa me të cilat do të parandalohet zhdukja, humbja ose dëmtimi i objekteve, ndërsa pas ndërprerjes së mandatit objektet me të cilat është ngarkuar ia kthen shërbimit kompetent të Kuvendit.

#### IV. SHKELJA E KODIT

#### Shkelje të lehta

##### Neni 13

Shkelje të lehta të Kodit janë:

- sjellja e deputetit me të cilën priset rrjedha e seancës/mbledhjes (hedhja fjalë

nga vendi, ndërprerja e fjalimit dhe ngjashëm);

- përdorimi i telefonit celular ose laptopit me ç'rast prishet rrjedha e seancës/mbledhjes;

- mosrespektimi i rregullave të veshmbathjes modeste në seanca/mbledhje dhe në ngjarje tjera në të cilat merr pjesë si përfaqësues i Kuvendit; dhe

- sjellja e deputetit me të cilën cenohet reputacioni dhe dinjiteti i Kuvendit.

#### Shkelje të rënda

##### Neni 14

Shkelje të rënda të Kodit janë:

- përdorimi i fjalëve, shprehjeve ose të sinonimeve të tyre me të cilat përçmohen persona të tjerë dhe me të cilat cenohet dinjiteti i tyre;

- puna për interes personal, për interes të individit ose të një grupi individësh, për fitimin e dobisë së drejtpërdrejtë ose të tërthortë;

- nxitja e urrejtjes, intolerancës ose dhunës;

- ushtron presion mbi nëpunësit shtetërorë dhe mbi të punësuarit e tjerë në shërbimin e Kuvendit gjatë kryerjes së detyrave të tyre të punës; dhe

- keqpërdorimi i funksionit për realizimin e interesave personale.

#### Autoriteti kompetent i Kuvendit

##### Neni 15

(1) Komisioni për Çështje të Rregullores, Mandatit dhe Imunitetit të Kuvendit (në tekstin në vijim: Komisioni) është kompetent për përcaktimin e shkeljeve të kryera të lehta dhe të rënda dhe shqiptimin e masave.

(2) Komisioni për konsultime do të thërrasë dy ekspertë për çështje etike, nga të cilët njëri është me propozim të grupeve të deputetëve të partive në pushtet ndërsa tjetri me propozim të grupeve të deputetëve të partive në opozitë.

(3) Komisioni me akt e rregullon procedurën e përcaktimit të shkeljeve të kryera të lehta dhe të rënda dhe shqiptimit të masave.

(4) Komisioni mban evidencë për të gjitha aktivitetet.

#### Masat për shkeljen e Kodit

##### Neni 16

(1) Komisioni për Çështje të Rregullores, Mandatit dhe Imunitetit për mosrespektimin e Kodit mund të shqiptojë:

- vërejtje, e cila shqiptohet për shkelje të lehtë, dhe

- vërejtje publike, e cila shqiptohet për shkelje të rëndë.

(2) Vendimet e Komisionit publikohen në ueb faqen e Kuvendit.

#### Parashkrimi

##### Neni 17

Procedura e shkeljes së Kodit parashkruhet në afat prej gjashtë muajsh nga dita e kryerjes së shkeljes.

V. DEKLARATË PËR MIRATIMIN E KODIT DHE  
PUBLIKIMI I KODIT

Deklaratë  
Neni 18

(1) Deputeti pas verifikimit të mandatit nënshkruan deklaratë me të cilën deklaron se gjatë ushtrimit të funksionit deputet do t'i respektojë dispozitat e këtij Kodi. Një ekzemplar nga deklarata e nënshkruar deputeti ia dorëzon Komisionit.

(2) Formën dhe përmbajtjen e formularit të deklaratës e përcakton Komisioni.

Publikimi i Kodit  
Neni 19

Ky Kod publikohet në ueb faqen e Kuvendit.

Neni 20

Dispozitat e neneve 6 dhe 7 të këtij Kodi në mënyrë përkatëse kanë të bëjnë edhe me personat e zgjedhur dhe të emëruar gjatë ushtrimit të të drejtave dhe obligimeve të tyre në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

VI. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 21

(1) Komisioni në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Kodi do ta përcaktojë formularin e deklaratës dhe të njëjtin e publikon në ueb faqen e Kuvendit.

(2) Deputeti e plotëson formularin dhe të njëjtin e nënshkruan pas publikimit të tij në ueb faqen e Kuvendit.

Hyrja në fuqi  
Neni 22

Ky Kod hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Numër 08 - \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_ 2018  
Shkup

KRYETARI I  
KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË  
MAQEDONISË  
**mr. Talat Xhaferi, d.v.**